REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME/MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA/MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister
Nr./Br./No. 0468 Nr. fq./Broj str./No. pg. 1
Data/Datum/Date 29.07.2021
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

29.07.2021
03 | 47 | 1401 | 5

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria –Vlada-Government***

**Ministria e Punëve të Brendshme**

**Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs**

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Xhelal Sveçla, Ministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme

XHELAL SVEÇLA

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për pasqyrat financiare te vitit 2020**

| Nr. | | Çështja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë | Zyrtari/ët përgjegjës | Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 1 | **Çështja A1** - Kompensim i parregullt i stafit të AME-së për punë jashtë orarit, ndërrimeve të natës dhe festave | **Rekomandimi A1-** Ministri dhe Drejtori i AME-së duhet të marrin masa për të siguruar kthimin e mjeteve të paguara për stafin që nuk janë zjarrfikës dhe të sigurojë që mos të ndodhin në të ardhmen pagesa që nuk janë në pajtim me legjislacionin në fuqi. | Lënda e dërguar në hetuesi. | Departamenti Ligjor i MPB | Varësisht nga data e lëshimit të vendimit nga organi hetues |
| 2. | 3 | **Çështja A2** - Regjistri jo i plotë i pasurive kapitale | **Rekomandimi A2-** Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së dhe Drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të sigurojnë që regjistri i pasurive të azhurnohet dhe objektet të cilat nuk janë të regjistruara të regjistrohen sipas kërkesave të rregullores në mënyrë që vlera e pasurive në PFV të jetë e plotë. | -PK- Sektori i aseteve do të koordinoj procesin me MFTH.<br><br>-AKSP- Drejtori i Përgjithshëm me vendim do të themeloj komisionin për vlerësimin e objekteve të trashëgurara si pasuri e organizatës. | Shefi i Sektorit të Aseteve/PK<br><br>Zyrtari i pasurisë/AKSP | Dhjetor 2021<br><br>Dhjetor 2021 |
| 3. | 4 | **Çështja A3** - Dobësi në menaxhim të pasurisë | **Rekomandimi A3-** Ministri duhet të sigurojë që regjistri i pasurisë të azhurnohet në vazhdimësi në raport me projektet e përfunduara duke i respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat e kërkuara me rregulloren e aplikueshme të pasurisë. | Korrigjimet në regjistrin kontabël | ZKF MPB | Janar 2022 |
| 4. | 6 | **Çështja A4** - Kompensim i parregullt për Sekretarinë e Bordit të AKSP-së | **Rekomandimi A4-** Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të ndërmarrin masa në kthimin e mjeteve për kompensime të pa rregullta dhe të sigurojë që në të ardhmen kompensimet e Sekretarisë së Bordit të AKSP-së të bëhen vetëm mbi bazën e legjislacionit në fuqi. | AKSP-Drejtori i Përgjithshëm nxjerr vendim për anulimin e vendimit dhe gjetja e modalitetit dhe formës ligjore për zbatim të rekomandimit në konsultim me MFTH. | ZKA i AKSP | Gusht 2021 |
| 5. | 14 | **Çështja A5** - Emërimi i menaxherit të kontratës jo | **Rekomandimi A5-** Ministri duhet të siguroj që të ketë ndarje adekuate të detyrave në rastet e | a). Është dërguar në hetuesi. | a). Departamenti Ligjor i MPB | Varësisht nga data e lëshimit të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në pajtim me kërkesat ligjore | emërimit të menaxherëve të kontratës në mënyrë që të parandalohet konflikti i interesit. | b). Për rastin e PK të adresohet përmes standardeve të brendshme të policisë dhe masave administrative. | b). ZKA PK | vendimit nga organi hetues |
| 6. | 7 | **Çështja A6** - Dobësi në procedurën e prokurimit | **Rekomandimi A6**- Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së të siguroj që në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktohen afatet kohore të kontratave si dhe kontratat publike kornizë të mos tejkalohen. | Lënda e dërguar në hetuesi. | Departamenti Ligjor i MPB | Varësisht nga data e lëshimit të vendimit nga organi hetues |
| 7. | 10 | **Çështja A7** - Pagesa e bërë pas përfundimit të afatit të kontratës | **Rekomandimi A7**- Ministri në bashkëpunim me akterët e përfshirë në këtë proces duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar zgjidhjen e kësaj situate. | Jemi në fazën e përfundimtare të marrëveshjes. | ZKA dhe Departamenti Ligjor i MPB | Shtator 2021 |
| 8. | 11 | **Çështja A8** - Pagesa për shujta për stafin e AKSP-së | **Rekomandimi A8**- Ministri, respektivisht Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të rishikojnë vendimin për shujta ditore dhe të ndërmarrin masa për ndalimin e tyre nga kategoria mallra dhe shërbime. | Lënda e dërguar në hetuesi. | Departamenti Ligjor i MPB | Varësisht nga data e lëshimit të vendimit nga organi hetues |
| 9. | 13 | **Çështja A9** - Mos-njoftim i KRPP-së për refuzim të tenderit me çmim jo normalisht të ulët | **Rekomandimi A9**- Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të sigurojnë përmbushjen e kërkesave ligjore në raport me KRPP-në duke e njoftuar atë në të gjitha rastet kur kjo kërkesë është obligative. | Lënda e dërguar në hetuesi. | Departamenti Ligjor i MPB | Varësisht nga data e lëshimit të vendimit nga organi hetues |
| 10. | 15 | **Çështja A10** - Mos-realizim i projektit brenda afatit kohor | **Rekomandimi A10**- Ministri duhet të ndërmerr masa konkrete përmes të cilave siguron realizimin e projektit për Spitalin e Prishtinës. | a). Fillimisht do të kërkohet raport nga përgjegjësit për dështimin e kryerjes së punëve paraprake për realizimin e projektit.<br>b). Ky projekt do të diskutohet në nivel të ministrive përkatëse për ta jetësuar vitin në vijim. | a). ZKA & Drejtori i DSPIMNQ;<br><br>b). MPB, MSH & KK Prishtinë | a). Shtator 2021;<br><br>b). Tetor 2022 |
| 11. | 2 | **Çështja B1** - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente | **Rekomandimi B1**- Ministri në bashkëpunim me drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të siguroj që detyrimet kontingjente të prezantohen në shuma të sakta si dhe të mbajë evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore. | a). Policia- Hartimi i listës me çështjet të cilat janë në procese gjyqësore, që janë të prezantuara si detyrime kontigjente.<br>b). PK të formojë komision që të konstatohet se vepra është raportim i pasaktë ose i qëllimshëm. | a). Shefi i Sektorit për Çështje Ligjore/PK;<br><br>b). ZKA PK | Dhjetor 2021 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12. | 8 | **Çështja B2** - Kompensim i pagave pa vijueshmëri në punë | **Rekomandimi B2-** Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar krijimin e kushteve për vijueshmërinë e rregullt në punë të komunitetit serb, kompensimin e tyre me pagë vetëm pas paraqitjes së rregullt në punë duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet nënligjore. | Rasti do të adresohet dhe diskutohet në nivel qeveritar për vendimmarrje | Ministri i MPB | Shtator 2021 |
| 13 | 9 | Çështja B3 - Tejkalimi i vlerës së kontratës kornizë | **Rekomandimi B3-** Ministri duhet të sigurojë që mos të bëhen tejkalime të kontratave mbi normën e lejuar 30% dhe kontratat të cilat tashmë kanë tejkaluar limitet e lejuara të ndërpriten menjëherë. | Lënda e dërguar në hetuesi. | Departamenti Ligjor i MPB | Varësisht nga data e lëshimit të vendimit nga organi hetues |
| 14 | 16 | **Çështja B4** - Regjistrim dhe raportim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme (LLA) | **Rekomandimi B4-** Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të siguroj se fletëparaqitjet për kundërvajtje të cilat kalojnë në gjykata mos të përfshihen në llogaritë e arkëtueshme si dhe me rastin e regjistrimit të gjobave në sistem të paraqiten vlerat e sakta të gjobave në mënyrë që LI/A të prezantohen drejtë në RVF. | ZKA PK në bashkëpunim me Drejtorin e TI, të veprohet sipas rekomandimit që gjobat në procedurë gjyqësore të mos përfshihen në llogari të arkëtueshme. | Drejtor i Divizionit të Komunikacionit Rrugor / PK | Dhjetor 2021 |
| 15 | 5 | **Çështja C1** - Regjistri jo i plotë dhe i saktë i pasurive jo kapitale | **Rekomandimi C1-** Ministri duhet të merr masa që në koordinim me akterët përgjegjës të zgjidhen problemet me sistemin E-pasuria në mënyrë që gjendja e pasurisë jo-kapitale të entitetit të prezantohet saktë. | Drejtori i IPK të raportoj pse ka ndodhur, ndëshkimet ndaj përgjegjësit dhe njëherit korrigjim i menjëhershëm i gabimit.<br>Pashtu Drejtori i AKSP e ZKF MPB do të korrigjojnë regjistrimet në softuer e-pasuria.<br><br>Sa i përket funksionlitetit të vetë softuerit e-pasuria, bazuar në raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitet e audituara 2010 – 2017, vetë softueri ka pengesa e dobësi të mëdha. Kjo çështje është adresuar përmes analizimit të menaxhimit të kontratës dhe krijimit të një komisioni apo grupi punues i cili ka filluar me skanim të gjendjes (jo vetëm të e-pasuria) por për tërë sistemin e IT në nivel vendi. Varësisht nga të dalat e raportit të | ZKA i IPK<br>ZKF i MPB dhe ZKF i AKSP<br><br>Komisioni/grupi punues | Dhjetor 2021<br><br>2021 - 2022 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | komisionit do të marrim masa poashtu në nivel vendi për tërë sistemin e IT përderisa ky sistem apo softuer është në portfolion e ASHI-së. | | |
| 16 | 12 | **Çështja C2** - Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara | **Rekomandimi C2-** Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe procesi i gradimit të zhvillohet duke iu përgjigjur nevojave të PK-së. | Problem i evidentuar edhe përmes auditimit të vitit paraprak e që vërehet përmirësimi në vitin vijues. Meqenëse këto veprime janë konsideruar të pamjaftueshme nga auditori, tani në bashkëpunim me Drejtorin e PK do të vazhdojmë me rishikimin e standardeve profesionale, nevojave, gradave përkatëse dhe modalitetin për të rregulluar sistemimet sipas gradimeve. | Departamenti i Burimeve Njerzore/PK | 2021 - 2022 |

27 korrik 2021, Prishtine